R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË

NJOFTIM

PËR DATËN, VENDIN DHE ORËN E ZHVILLIMIT TË PROVIMIT TË PRANIMIT NË TRAJNIMIN FILLESTAR

Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë njofton se, Provimi i Pranimit në Programin e Trajnimit Fillestar pranë Qendrës Kombëtare të Trajnimit të Përmbaruesve, do të zhvillohet në:

Datë: 24.11.2026
Vendi: Pranë Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë
Ora: 17:30

Pyetjet e provimit të pranimit në formimin fillestar do të bazohen në përmbajtjen e programit të detyrueshëm të trajnimit fillestar mbi tematika dhe aspekte bazike që përfshijnë:

Kodin Civil; Kodin e Procedurës Civile; Të drejtën private; Legjislacionit për shërbimin përmbarimor gjyqësor; Aspekte të veçanta të së drejtës publike dhe etikën profesionale.

Hyrja për në ambientet e brendshme për zhvillimin e provimit të pranimit do bëhet 30 minuta përpara orarit të njoftuar për zhvillimin e provimit. Ndaj të interesuarit e kualifikuar për të marrë pjesë në provim, duhet të paraqiten në ditën e provimit, në ambientin e caktuar për zhvillimin e tij, të pajisur me mjet identifikimi personal të vlefshëm, që në orën **17:00**.

Kandidatët që nuk paraqiten në orarin e kërkuar dhe nuk kanë mjet identifikimi të vlefshëm, përjashtohen nga e drejta për të marrë pjesë në provim.

Ftohen të gjithë kandidatët e kualifikuar për të marrë pjesë në provim, të njihen paraprakisht me rregullat e detajuara për zhvillimin e provimit të pranimit, sipas përcaktimeve të urdhrit nr. 364, datë 31.5.2021 të ministrit të Drejtësisë "*Për miratimin e "Programit të detyrueshëm për trajnimin fillestar*", publikuar edhe në fletoren zyrtare.

Ky njoftim publikohet në faqen zyrtare të Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë dhe të Ministrisë së Drejtësisë, sipas përcaktimeve ligjore.